

VENDIM
Nr. 108, datë 31.5.2024

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 111, DATË 27.3.2023,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘TPLANI HC’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘VALBONA’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2100 kw”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1317/1 prot., datë 29.5.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 111, datë 27.3.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘TPLANI HC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Valbona’, me kapacitet të instaluar 2100 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 111, datë 27.3.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “TPLANI HC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw, për një afat 20 vjet e 10 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të depozitohet në ERE lejen për përdorimin e burimit uJOR.

- ERE, me shkresën nr. 99/18 prot., datë 5.4.2023, njoftoi shoqërinë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., mbi vendimin e Bordit të ERE-s nr. 111/2023.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1317 prot., datë 29.5.2024, ka depozituar lejen për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor nr. 222 prot., datë 21.5.2024, të miratuar me vendimin e Këshillit të Basenit UJOR Drin-Bunë nr. 8., datë 20.5.2024, për prodhim hidroenergjie nga HEC “Valbona”. Në këtë leje përcaktohet, **se periudha e vlefshmërisë së saj është sipas afateve të Konkensionit deri më datën 28.1.2044.**

- Me depozitimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR me afat koncensionar si më sipër, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111, datë 23.7.2023, ndaj vlerësohet të hiqet kushti për depozitimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor.

- Me plotësimin e këtij kushti nuk gjen më zbatim as pika 2 e vendimit nr. 111/2023, si e tillë, kjo pikë vlerësohet të shfuqizohet.

- Shoqëria “TPLANI HC” sh.p.k. është e licencuar për një afat 20 vjet e 10 muaj, pasi kontratën e koncesionit me nr. 279 rep., nr. 38 kol., datë 29.1.2009, e ka për një afat 35-vjeçar. ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit sipërcituar, rezultonte se shoqëria kishte humbur afërsisht 14 vjet e 2 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha që mbetet për licencim është 20 vjet e 10 muaj. Si e tillë, shoqëria me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 111/2023 është licencuar për afatin e mbetur.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e

vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111, datë 27.3.2023, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “TPLANI HC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw, për një afat 20 vjet e 10 muaj (duke nisur nga data e vendimit nr. 111/2023 deri më datën 27.1.2044).”.

2. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111, datë 27.3.2023, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “TPLANI HC” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes sh.a., Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti